



**REPUBLIKA E KOSOVËS /**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

---

**C.nr.121/19**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, Gjyqtari Besnik Bislimaj, me zyrtaren ligjore Merita Xharavina, duke vepruar në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.H. nga Gjakova, të cilin e përfaqëson U.P., avokat nga Gjakova, kundër të paditurës K.Gj.-D.A., për shkak të kompensimit tri pagave për përcjellje në pension dhe shpërblim jubilarë, me vlerë kontesti 2,126.00.-€ jashtë shqyrtimit me date 16.07.2019, merr këtë:

**AKTGJYKIM**  
**PËR SHKAK TË MOSBINDJES**

**APROVOHET** kërkesë-padia e paditësit H.H. nga Gjakova, dhe **DETYROHET** e paditura K.Gj.-D.A., që paditësit H.H. nga Gjakova., t' ia paguaj borxhin në emër të tri pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave të shpërblim jubilar në shumë prej 2.126.00.-€, dhe atë me kamatë ligjore 8% nga momenti i ushtrimit të padisë, me datë 20.02.2019 e gjerë në pagesën definitive si dhe të kompensoj të gjitha shpenzimet procedurale në shumë prej 134.00 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Paditësi H.H. nga Gjakova, përmes përfaqësuesit të tij U.P., avokat nga Gjakova pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 20.02.2019, kundër të paditurës K.Gj.-D.A., për shkak të kompensimit tri pagave për përcjellje në pension dhe shpërblim jubilarë, me vlerë kontesti 2.126.00.-€.

Në kuptim të nenit 394 të Ligjit për procedurën kontestimore, Gjykata me aktvendim C.nr.121/19 të datës 13.03.2019, ka obliguar të paditurën që në afat prej 15 ditësh të japë përgjigje në padi duke u deklaruar nëse e pranon kërkesë-padinë e paditësit, apo e kundërshton kërkesë-padinë e paditësit, dhe nëse e njëjta kundërshtohet, ta arsyetoj kundërshtimin duke bashkangjitur edhe provat.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Aktvendimi i sipërcituar nga pala e paditur është marrë me datë 20.03.2019 dhe gjerë më tani e paditura nuk ka parashtruar përgjigje në padi edhe pse gjykata me aktvendim për përgjigjen në padi i'a ka tërhequr vërejtjen se në rast të mos veprimi sipas atij aktvendimi do të përballet me pasojat ligjore.

Meqenëse e paditura brenda afatit të përcaktuar me ligj, nuk i kanë paraqitur Gjykatës përgjigje në padi. Andaj, mbështetur në nenin 150.1. të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), ky aktgjykim u murr për shkak të pa dëgjueshmërisë, përkatësisht mosbindjes, sepse janë plotësuar këto kushte: a) *të paditurit padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi i është dorëzuar në mënyrë të rregullt, b) themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi, c) faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi*, andaj dhe gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 160.6 të Ligjit për Procedurën Kontestimore janë dhënë vetëm arsyet që e justifikojnë dhënien e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 452.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro, taksë gjyqësore për padi në shumë prej 30 euro,, e në shumë të përgjithshme prej 134.00 euro. pasi që gjykata kishte prova se të njëjtat taksa janë paguar nga paditësi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**C.nr.121/19, me datë 16.07.2019**

**GJYQTARI:**  
**Besnik Bislimaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë Ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së këtij Aktgjykimi Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.